



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

ANALIZË E BIZNESEVE PËRFITUESE (START UP- PZHRB) 2018-2022

Departamenti për
Planifikim
dhe Analiza Socio-
Ekonomike
Rajonale



Korrik, 2023

Ky dokument është hartuar nga Grupi Punues:

Vjendita Avdiu Musliu - Udhëheqëse e Divizionit për Zhvillim Rajonal;
Butrint Marmullaku - Zyrtar për Monitorimin e Projekteve;
Blinda Bytyçi - Konsulente për Zhvillim Socio-Ekonomik;

Ky dokument është produkt i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, dhe i njeiti duhet të shërbej për nevojat e vet këtij institucioni, ministrive të linjës dhe bizneseve të sektorit privat të Republikës së Kosovës, lidhur me hartimin dhe zhvillimin e programeve në ndikim të mjedisit biznesor.

Copyright. 2023 - Ministria e Zhvillimit Rajonal
Republika e Kosovës, 10 000 Prishtinë
Kati: X Ndërtesa ish Rilindja, Prishtinë
Tel: +383(0)38 200 64 526
<https://mzhr.rks-gov.net/>

Tabela e përmbajtjes:

1 PËRMBLEDHJE

2 QËLLIMI

3 OBJEKTIVAT

4 METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

5 PROGRAMI PËR ZHVILLIM RAJONAL TË
BALANCUAR PZHRB, KATEGORIA START-UP

6 TRAJTIMI I UDHËZUESIT PËR GRANTE MZHR

7 GJETJET E ANKETËS

8 KONKLuzionet dhe Rekomandimet

9 BURIMET E INFORMACIONIT

Përmbledhje

Ministria e Zhvillimit Rajonal - MZHR që nga themelimi i saj zhvillon dhe implementon programe që synim kanë ndikimin në zhvillimin rajonal të balancuar përmes zvogëlimit të pabarazive rajonale. Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR) bazuar në mandatin e saj ligjor të përcaktuar me Shtojcën (15), të Rregullores (QR) Nr. 02/2021, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 për fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe Planin e Punës për vitin 2022. Synimi i përgjithshëm i këtyre programeve është zhvillimi socio-ekonomik rajonal i balancuar përmes zhvillimit të ndërmarrësisë në pesë rajone zhvillimore në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

MZHR orienton programet që sigurojnë zhvillimin e balancuar rajonal, ekonomik dhe shoqëror. Zhvillimi rajonal i balancuar - nënkupton procesin e uljes së dallimeve në aspekt të zhvillimit socio-ekonomik si dhe përafrimi i nivelit të zhvillimit ekonomik, social, kulturor e mjedisor, ndërmjet rajoneve të ndryshme zhvillimore përmes shfrytëzimit të potencialeve të tyre sa i përket resurseve financiare, natyrore dhe kapitalit njerëzor.



Rajon zhvillimor - nënkupton territorin funksional që përfshinë dy apo më shumë njësi të vetëqeverisjes lokale, në përputhje me kriteret e NUTS-3, për zbatimin e politikave të zhvillimit rajonal, i cili dallohet nga një tërësi karakteristikash gjeografike, socio-ekonomike, kulturore, mjedisore. Rajoni zhvillimor përfshinë zhvillimin socio-ekonomik rajonal të balancuar, në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi dhe në asnjë rrethanë nuk nënkupton organizim administrativ apo territorial. Në analizë Programi PZHRB kategoria (Start-Up) është trajtuar në bazë të pesë rajoneve me të cilat MZHR realizon mandatin e saj ligjor.

Qëllimi i Analizës

Kjo analizë bëhet me qëllim të matjes së ndikimit të implementimit të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar PZHRB, tek bizneset në themelim (Start-Up).

Në këtë analizë trajtohen vetëm përfituesit e projekteve nga Skema e Granteve (PZHRB) e implementuar nga Ministria e Zhvillimit Rajonal për periudhën e implementimit (2018-2022).



Trajtimi i objektivave të dokumentit sipas të dhënave që janë gjeneruar nga pyetësi

- Bizneset aktive nga Skema e Granteve kategoria Start Up, Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar 2018-2022;
- Të dhënat demografike të përfituesëve (mosha mesatare, gjinia, etniciteti, edukimi) nga kategoria Start Up, PZHRB 2018-2022;
- Sektori/veprimtaria më e përfaqësuar nga kategoria Start Up, PZHRB 2018-2022;
- Ndikimi i financimit tek projektet përfituese, qëndrueshmëria bizneseve, qëndrueshmëria e punësimit, eksporti;
- Sfidat gjatë themelimit të bizneseve përfituese kategoria Start Up, PZHRB 2018-2022;
- Sfidat gjatë implementimit të bizneseve kategoria Start Up, PZHRB 2018-2022;
- Ndikimet e drejtpërdrejta pozitive të Programit PZHRB kategoria Start Up, 2018-2022 dhe matja e pritshmërive;
- Bizneset jo-aktive nga Skema e Granteve PZHRB kategoria Start Up, 2018-2022;
- Rekomandimet nga përfituesit e bizneseve për Skemën e Granteve PZHRB kategoria Start Up, 2018-2022;

Rezultatet dhe rekomandimet.

Metodologjia


Të dhënat primare janë mbledhur përmes pyetësorit anketues nga përfituesit e projekteve nga Skema e Granteve kategoria (Start-Up) PZHRB për periudhen 2018-2022. Me qëllim që mostra të jetë sa më e përfaqësueshme pyetësi është dërguar tek 473 respondentë, përfitues të Skemës së Granteve PZHRB, kategoria (Start-Up), periudha 2018-2022 dhe janë përgjigjur 111 respondentë nga bizneset përfituese. Anketa është realizuar në formë elektronike dhe është shpërndarë përmes e-mailit. Pyetësi ka përmbajtur pyetje të strukturuar dhe të pastrukturuar në mënyrë që të gjenerojë sa më shumë informacione për qëllimin e hulumtimit. Pyetësi është organizuar me katër kapituj kryesor: (I) Informatat e përgjithshme; (II) Informatat e biznesit dhe ndikimi i financimit (PZHRB); (III) Punësimi; (IV) Sfidat gjatë procesit të implementimit të Skemës së Granteve (PZHRB). Të dhënat sekondare janë përdorur nga analizat dhe raportet e ndryshme të hartuara nga MZHR dhe raporte të tjera.

Këto të dhëna janë përpunuar dhe prezantuar në dokument sipas objektivave të përcaktuara. Rezultatet janë shtjelluar detajisht në analizë dhe janë dhënë konkluzione dhe udhëzime. Dokumenti është konsultuar me strukturat e brendshme menaxheriale të MZHR-së. Gjithashtu është konsideruar e rëndësishme të zhvillohen edhe konsultime në nivel qendror me Ministrinë e Linjës që të ndahen dhe konsultohen praktikat më të mira me këto institucione që implementojnë skemat e granteve ku mbështetet sektori privat si: MINT, Departmenti i Inovacionit në MINT, MBPZHR etj.

Kontributi: ky dokument ofron një pasqyrim të detajuar të implementimit të Skemës së Granteve të sektorit privat për periudhen 2018-2022 bazuar në përgjigjet e respondentëve (përfitues të projekteve) dhe ndikimit që ka pasur kjo skemë për të stimuluar projekte ideore inovative përmes zvogëlimit të pabarazive rajonale, duke i kontribuar një zhvillimi të qëndrueshëm socio - ekonomik.

Çka është një biznes Start-Up

Start – Up është një ide biznesi në themelim. Ky term i referohet një biznesi në fazat e para të operimit. Në Start-Up një ndërmarrës merr përsipër një rrezik për të krijuar diçka të re, merr përsipër një iniciativë për të krijuar dhe zhvilluar një ide të re biznesi për të i'u shërbyer konsumatorëve për plotësimin e një nevojë apo në zgjidhjen e një problemi të caktuar përmes ofrimit të produkteve dhe shërbimeve të caktuara.




Për bizneset e kategorisë Start Up kemi definicione dhe qasje të ndryshme nga institucione dhe organizata të tjera. Një Start Up-i përveç themelimit të një biznesit të ri shumë i referohen një biznesi ekzistues por që koha ekzistimit të tij si biznes në treg nuk është shumë e gjatë. Të tjerë një biznes Start Up e konsiderojnë një biznes që vjen me një ide inovative të produktit/shërbimit në treg. Mënyra se si trajtohet ky term i biznesit është e ndryshme, por që në thelb ka nxitjen ndërmarrësve të rinjë drejt realizimit të ide/projekteve dhe hapjen e bizneseve të reja me qëllim të ndikimit në zhvillimin e ekonomisë nëpërmjet hapjes së vendeve të reja të punës, qëndrueshmërisë, rritjen e eksportit etj. Ekosistemi i mjedisit të Start Up-ve përfshinë disa faza dhe elemente mjaft sfiduese gjatë realizimit si: *idea, planifikimi, edukimi, mentorimi, tregu, financimi, implementimi, marketingu etj.* Praktika tjera të shumta trajtojnë këto lloj biznese fillestare përmes inkubatorëve të biznesit që janë një grup njerëzish, organizatash, institucionesh, etj që mbështesin dhe promovojnë rritjen e biznesve të reja. Duke ofruar hapësirë zyre, mbështetje financiare, mentorim dhe trajnime të fushës inkubatorët mbështesin ndërmarrësit në tejkalimin e disa sfidave të qenësishme për nisjen e një biznesi të ri. Sipërmarrja e krijimit të një biznesi të ri për themeluesit përbën një mjedis jo shumë të qëndrueshëm në fillim me mundësi rreziku dhe sfidues, pasi që koha e konsolidimit të këtij lloji të biznesit përfshinë një periudhë kohore deri në tre vite jetëgjatësi për tu konsideruar një biznes i qëndrueshëm në treg. Sipas Peter Thiel, një nga bashkëthemeluesit e PayPal citon se është shumë më e lehtë për një biznes të ri të dominojë një treg të vogël se sa një treg më të madh dhe më të vendosur. Kontrolli mbi një treg të vogël mund të akselerojnë një biznes në tregje të reja, me hapa të sigurta.

Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar PZHRB, Kategoria (Start-Up)

Sektori privat është një ndër sektorët më të rëndësishëm për një zhvillim të gjerë e të qëndrueshëm ekonomik. Duke ditur rëndësinë e kësaj mbështetje ndaj sektorit privat ka qenë dhe mbetet në qendër të prioritetëve të programeve të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal me qëllim të ndikimit të zhvillimit rajonal përmes implementimit të projekteve në sektorin privat, në përkrahje të bizneseve përmes financimit të ide-projekteve të reja.

Programi për mbështetje ndaj sektorit privat në kuadër të kategorisë (Start Up) është financuar nga MZHR që nga viti 2018 si vit i parë i realizimit të këtij programi dhe vazhdon ende në kuadër të kësaj skeme. Me qëllim të ndikimit në hapjen e bizneseve të reja dhe krijimit të kushteve për hapjen e vendeve të reja të punës si dhe qëndrueshmërisë së tyre në treg, MZHR përmes këtij programi ofron mbështetje financiare në paisje që lidhen direkt me prodhimin/shërbimin për të gjithë aplikuesit që konkurrojnë me një ide projekt të caktuar në fushëveprimtaritë që MZHR mbështet përmes financimit. Ky program implementohet në pesë rajone zhvillimore të Kosovës duke u munduar kështu të ndikojë në zhvillimin rajonal përmes zvogëlimit të pabarazive rajonale. Përmes mbështetjes MZHR synon të ndikojë në fuqizim të sektorit privat duke ndikuar edhe në rritjen e eksportit dhe zvogëlimin e importit të produkteve dhe shërbimeve me të cilat Kosova ka potencial të jetë e konkurrueshme në treg. Duke analizuar mjedisin, klimën e funksionimit të bizneseve në tregun tonë ky sektor ndër vite ka kaluar nëpër sfida të ndryshme. Bazuar në këtë Departamenti për Planifikim dhe Analiza Socio-Ekonomike Rajonale këtë vit harton analizën rreth funksionimit të kategorisë Start Up në kuadër të këtij programi me qëllim të identifikimit të sfidave, vështirësive, rreziqeve gjatë procesit të themelimit dhe konsolidimit të këtyre bizneseve por gjithashtu duke identifikuar përparësitë dhe potencialet e zhvillimit përmes këtyre ide-projekteve në treg. Analiza bazohet në përfituesit e projekteve Start-Up në kuadër të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar të implementuar nga Skema e Granteve nga MZHR për periudhën kohore 2018-2022.

Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar është dokument i programimit që përcakton aktivitetet për arritjen e objektivave sipas prioriteteve për zhvillim rajonal të balancuar, burimet financiare dhe autoritetet përgjegjëse. Ministria e Zhvillimit Rajonal, bazuar në mandatin ligjor, çdo vit zhvillon, implementon dhe menaxhon programe për zhvillim rajonal të balancuar, programe këto që rrisin zhvillimin socio – ekonomik të balancuar në rajonet zhvillimore të Kosovës, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejt në hapjen dhe zhvillimin e bizneseve, zgjerimin e kapaciteteve të tyre prodhuese apo shërbyese, gjenerimin e vendeve të reja të punës si dhe zvogëlimin e importit dhe nxitjen e eksportit.



Procesi i implementimit të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar PZHRB, Kategoria Start Up

Synimi i përgjithshëm i thirrjes për propozime është zhvillimi socio-ekonomik rajonal i balancuar përmes zhvillimit të ndërmarrësisë në Rajonet Zhvillimore të Kosovës.


Synimet specifike të kësaj thirrjeje për propozime janë:

1. Përkrahja e bizneseve të reja dhe zhvillimi i bizneseve me potencial rritjeje;
2. Përkrahja e bizneseve që kontribuojnë në zëvendësimin e importeve;
3. Përkrahja e bizneseve që kontribuojnë në rritjen e eksportit;
4. Zvogëlimi i papunësisë përmes krijimit të vendeve të reja të punës, me theks të veçantë për të rinjtë.

Ministria e Zhvillimit Rajonal përmes mbështetjes financiare që nga viti 2018 deri në 2022 ka implementuar suksesshëm Programin për Zhvillim Rajonal të Balancuar në mbështetje të sektorit privat përmes nxitjes së ndërmarrësisë në zhvillim të ide projekteve të reja nga kategoria Start Up. Në këtë kategori për periudhën 2018-2022 MZHR ka realizuar vlerën e financimit prej 1,966,699.77€ duke mbështetur gjithsej 496 projekte përfituese. Kategoria Start Up ka filluar implementimin me një buxhet fillestar prej 322,180.95€ në vitin 2018 dhe ka pasur një rritje 62% të buxhetit deri në vitin 2022 në vlerën e investuar për këtë kategori që tregon rritje mjaft progresive duke arritur vlerën prej 857,715.11 € të investuara për vitin 2022 me gjithsej 185 projekte të realizuara.

Vitet	2018	2019	2020	2021	2022
Vlera financiare	322,180.95	261,968.22	309,541.85	215,293.64	857,715.11
Përfitues të skemës së grantit	72	98	84	57	185

Tabela 1. Implementimi i projekteve kategoria Start Up PZHRB 2018-2022



Grafikoni 1. Implementimi i projekteve përfituese kategoria Start Up PZHRB 2018-2022


1 'Analiza e Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar PZHRB 2018-2020;

2 'Analiza e Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar PZHRB 2022.

Aplikimet nga kategoria Start Up 2018-2022 që nga viti i parë i implementimit të këtij programi Loti Start Up është kategoria me kërkesën më të madhe për aplikim të projekteve. Gjithsej numri i aplikimeve që nga viti 2018 deri në vitin 2022 ka arritur në shifrën prej 4285 aplikuesish.


- Viti i parë 2018 ka pasur gjithsej 733 aplikime;
- Viti i dytë 2019 ka pasur 702 aplikime;
- Viti i tretë 2020 ka pasur 1165 aplikime;
- Viti i katërt 2021 ka pasur 850 aplikime;
- Viti i pestë 2022 ka pasur gjithsej 835 aplikime.

Vërejmë që viti me kërkesën më të lartë është viti 2020 me gjithsej 1165 aplikime.



Grafikoni 2. Numri i aplikimeve për kategorinë Start Up PZHRB 2018-2022


Projektet përfituese nga Programi PZHRB 2018-2022 sipas etnisë: ndër vite në Programin për Zhvillim të Balancuar PZHRB numri më i madh i përfituesëve i takon projekteve përfituese (shqiptar) dhe rrjedhimisht edhe kategoria Start Up karakterizohet njejt me numrin më të madh, pasi që edhe kërkesat më të mëdha për këtë Program kanë qenë nga shqiptarët. Pavarësisht kësaj MZHR gjithmonë ka inkurajuar komunitetet tjera pakicë për të qenë pjesë e thirrjes PZHRB.



Grafikoni 3. Projektet përfituese sipas përkatësisë etnike PZHRB 2018-2022


Projektet përfituese sipas gjinisë PZHRB 2018- 2022

Në bazë të analizave të Skemës së Granteve PZHRB të implementuar për periudhën 2018-2022 grupi më i madh i projekteve përfituese me një diferencë të madhe i takon projekteve përfituese nga burrat, përveç vitit 2022 ku kemi një përafrim shumë të madh mes grave ndërmarrëse si përfituese të Skemës së Granteve me (87) projekte përfituese të përfaqësuara nga gratë ose (47%) nga totali i projekteve përfituese si dhe (98) projekte përfituese nga burrat ose (53%) nga totali i projekteve përfituese. MZHR në vazhdimësi ka inkurajuar gratë të jenë pjesë e Skemës së Granteve. Mëposhtë kemi paraqitur numrin e projekteve përfituese nga gratë për vitet 2018-2022 në kuadër të Skemës së Granteve PZHRB.



Grafikoni 4. Projektet përfituese nga gratë Skema e granteve PZHRB 2018-2022

MZHR përmes Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar PZHRB ka pasur rolin e vet ndikues në fuqizimin e grave në të bërit biznes përmes nxitjes së ndërmarrësisë duke i inkurajuar ato që të zhvillojnë idetë e tyre për biznes përmes skemës së granteve.




Grafikoni 5. Projektet përfituese nga gratë në (%) PZHRB 2018-2022

Punësimi kategoria Start UP, PZHRB 2018- 2022

Punësimi është element shumë i rëndësishëm për zhvillimin ekonomisë në një vend në zhvillim siç është Kosova. Krijimi i vendeve të reja të punës në fusha dhe sektor të ndryshëm, ka ndikim të lartë tek ekonomitë familjare duke ndikuar në mirëqenie dhe në rritje të standardit jetësor të tyre. Si rrjedhojë e kësaj kemi dhe rritje të konsumit duke i mundësuar në mënyrë të tërthortë përfitojnë edhe pjesë të tjera të zingjirit ekonomik. Punësimi është çelësi për uljen e varfërisë, dhe uljen e nivelit të korrupsionit. Një zhvillim shoqëror është i mundur vetëm me rritjen e punësimit të një vendi, përmes së cilës kemi edhe rritje të ekonomisë.

Zvogëlimi i papunësisë përmes krijimit të vendeve të reja të punës me theks të veçantë për të rinjtë, përkrahja e zhvillimit të bizneseve të reja dhe atyre me potencial rritjeje si dhe përkrahja e bizneseve që kontribuojnë në zëvendësimin e importeve, janë disa prej synimeve specifike që kontribuojnë në zhvillimin socio ekonomik rajonal. Referuar numrit të të punësuarve ndër vite vërejmë që MZHR ka arritur të ndikojë në përmbushjen e një prej objektivave kryesore të mandatit të saj për gjenerimin e vendeve të reja të punës. Më poshtë kemi paraqitur në mënyrë grafike numrin e bizneseve përfituese dhe numrin e vendeve të punësuar nga këto biznese nga Kategoria Start Up, PZHRB për periudhën 2018-2022.



Grafikoni 6. Numri i të punësuarëve nga bizneset përfituese
Kategoria Start Up, PZHRB 2018-2022

Trajtimi i Udhëzuesit për Aplikantë, Kategoria Start-Up, Skema e Granteve PZHRB

Udhëzuesi për Start Up të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar realizohet çdo vit konform hapjes së thirrjes për propozime së skemës së granteve. Udhëzuesit e kësaj skeme realizohen në bazë të Udhëzimit administrativ (MZHR) Nr.01/2022 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzuesit Administrativ MZHR Nr. 02/2018 për kriteret e përkrahjes së bizneseve/ ndërmarrësve të rinj nga Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar. Në këtë analizë DPASER ka trajtuar Udhëzuesin e fundit si më të avancuar për Skemen e v. 2023 në disa prej pikave kyçe të programit. Vlen të theksohet që MZHR prej v.2018 deri më sot ka avancuar Udhëzuesin për Aplikant në shumë pika si: vlera e financimit, vlera e qarkullimit, sektorët etj. Në kategorinë Start-Up sipas udhëzuesit të drejtë aplikimi kanë individët që nuk kanë ende biznese të regjistruara. Aplikimi mund të bëhet për sektorët dhe veprimtaritë pa përjashtim (përveç tregtia, ndërtimtaria, bujqësia, shëndetësia dhe arsimit);

Shuma e granteve

Në Skemën e Granteve PZHRB, kategoria (Start-Up) për periudhën 2018-2022 vlerat e financimit kanë variuar brenda shumave vijuese minimale dhe maksimale ku theksojmë që në v.2018 shuma minimale për financimin e Start Up-ve ka filluar nga vlera 1,000.00€ deri në 5,000.00. Kjo kategori ka avancuar në këtë drejtim dhe këtë vit kemi vlerë financimi duke filluar si mëposhtë:

Start-up: Nga 2,000.00 € deri në 5,000.00 €;

Secili grant i kërkuar sipas kriterëve të kësaj thirrje për propozime qëndron brenda përqindjeve minimale dhe maksimale të kostos totale të kualifikueshme për veprim. Për kategorinë START-UP përqindja e bashkëfinancimit nga aplikantët është nga 10% deri në 40% kurse shuma që kërkohet nga Ministria e Zhvillimit Rajonal nuk mund të jetë nën 60% e kostos totale të projekt propozimit;

Rregullat për Thirrjen për Propozime (Start Up)

Rregullat për dorëzimin, përzgjedhjen dhe implementimin e projekteve të financuara sipas kësaj thirrjeje për propozime përcaktohen sipas këtij Udhëzuesi. Ekzistojnë tre grupe të kriterëve për kualifikim, që kanë të bëjnë me:

1. Aplikantët që mund të kërkojnë grant;
2. Veprimet (lloji i projektit të biznesit) për të cilin mund të jepet granti;
3. Lloji i kostos që mund të merret në përcaktimin e shumës së grantit.

Kualifikimi i aplikantëve se kush mund të aplikojë!

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të jetë i regjistruar për aktivitetet e parapara me veprimin e propozuar në kohën e pranimin të grantit (Start-Up);
- Të mund të demonstrojë që të gjitha kontributet dhe tatimet janë përmbushur;
- Të jetë drejtpërdrejt përgjegjës për përgatitjen dhe menaxhimin e veprimeve.

Aplikantët që nuk kualifikohen

- Klasifikimi i tyre në Regjistrin e Kredisë Kosovës (apo siç njihet në banka CRK- Credit Registry of Kosova) të llogarive Personale dhe të Biznesit është nën kategorinë B – përjashtimisht në rastet kur sjellet dëshmia nga banka se biznesinuk ka obligime;
- Ata, apo personat që kanë autorizim përfaqësimi, vendimmarrjeje apo kontrolli mbi ta, janë dënuar për një vepër që ka të bëjë me sjelljen profesionale me aktgjykim të një autoriteti kompetent (pra kur nuk ka mundësi apelimi);
- Nuk janë në përputhje me obligimet e tyre sa i përket pagesës së kontributeve apo pagesës së tatimeve në pajtim me dispozitat ligjore të vendit në të cilin janë themeluar;
- Ata, apo personat që kanë autorizim përfaqësimi, vendimmarrjeje apo kontrolli mbi ta, kanë qenë subjekt i një aktgjykimi të prerë e të plotfuqishëm për mashtrim, korrupsion, përfshirje në organizatë kriminale, shpërlarje të parave apo ndonjë aktivitet tjetër të paligjshëm, ku aktiviteti i tillë i paligjshëm është dëmtues për interesat financiare të Kosovës.

Sektorët që kualifikohen

Ndërmarrjet që operojnë në prodhimin dhe përpunimin e produkteve, si dhe në shërbimet komerciale janë të kualifikuara të aplikojnë. Interes i veçantë i kushtohet projekteve që kanë mundësi të zëvendësojnë importet dhe të krijojnë eksporte që mbulojnë nevojat dhe prioritetet e mjedisit lokal.

Sektorët që Nuk kualifikohen në asnjë kategori të kësaj thirrjeje janë:

Tregtia (me pakicë dhe shumicë); Ndërtimtaria (përveç prodhimit të materialeve që përdoren në ndërtimtari – pra nuk kualifikohet ndërtimi i objekteve, blerja e mjeteve lëvizëse e të ngjashme, por kualifikohen pajisjet për prodhimin e materialeve që përdoren në ndërtimtari); Bujqësia për Start-Up dhe LOT 1 (çdo pajisje apo aktivitet që ndërlidhet me fushëveprimtarinë e bujqësisë që financohet nga MBPZHR përjashtimit pajisjet/makineritë për prodhimin dhe përpunimin e produkteve); Shëndetësia; Arsimi.

Kohëzgjatja dhe lokacioni i projektit

Kohëzgjatja e planifikuar e projektit që financohet nga MZHR nuk mund të tejkalojë 6 muaj (përveç nëse ndryshe parashihet me kushtet e kontratës). Veprimet duhet të ndërmerren në Republikën e Kosovës.

Kualifikueshmëria e shpenzimeve: kostot që mund të merren parasysht për grantin

Investimet në asete të prekshme që kanë të bëjnë ose me blerjen e pajisjeve, makinerisë, linjat e prodhimit, softuerë, si dhe të ngjashme apo/dhe përmirësimin e proceseve dhe metodave prodhuese si dhe duke përfshirë asetet që mund t'i ndihmojnë kompanive të jenë më pak të varura nga faktorët e jashtëm;

Trajnimi i specializuar në lidhje me investimet e lartpërmendura si përsëmbull trajnime për përdorimin e pajisjeve apo teknologjisë së re (sidoqoftë shpenzimet e trajnimeve nuk mund të kalojnë vlerën më shumë se 10% të vlerës totale të projektit);

Aktivitetet marketingu si përsëmbull pjesëmarrja në panaire, zhvillimi i webfaqeve, etj., për të promovuar produktet dhe shërbimet nga projekti (sidoqoftë shpenzimet e marketingut nuk mund të kalojnë vlerën më shumë se 10% të vlerës totale të projektit);

Mënyra e aplikimit

Aplikantët plotësojnë formularin e aplikimit duke përdorur formularin e aplikimit të dizajnuar nga autoriteti kontraktues. Në thirrjet e kaluara aplikimi është bërë nëpërmjet sistemeve elektronike SMAED dhe E-Kosova. Me funksionalizimin e sistemit E-kosova dhe aplikimin online Ministria e Zhvillimit Rajonal ka arritur avancim në: ekonomizimin dhe efektshmërinë e kohës gjatë procesit të aplikimit, avancimim e nivelit të aplikimit, ka rritur transparencën në raport me aplikantët dhe përshejtimin e procesit të vlerësimit.

MZHR organizon sesione informuese çdo vit pas hapjes së thirrjes lidhur për të gjithë të interesuarit. MZHR si çdo vit edhe këtë vit ka mbajtur sesione informuese për aplikantët potencial/bizneset sa i përket procedurave të aplikimit. Këto sesione organizohen vazhdimisht në koordinim me AZHR-të në Rajonet Zhvillimore me të cilat operon MZHR. Realizimi i sesioneve informuese për secilin rajon, për sqarimin e programeve dhe procedurave të aplikimit, ofrimit të përgjigjeve përmes web-faqes në pyetjet e parashtruara nga aplikantët gjatë procesit të aplikimit, si dhe publikimit në web faqe të udhëzuesve ku kanë qenë të specifikuar në detaje të gjitha kushtet dhe kriteret e përkrahjes së bizneseve dhe ndërmarrësve të rinjë nga Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar PZHRB përfshirë kategorinë Start Up. Kjo ka ndikuar shumë në krijimin e besueshmërisë tek programi PZHRB për qytetarët si dhe ka pasur dhe ka një rol edhe më të madh në proceset e llogaridhënies dhe rritjen e transparencës mes institucionit dhe qytetarit.

Kriteret e vlerësimit

Vlerësimi i aplikacioneve sipas udhëzuesit përfshinë: **Kontrollin administrativ**- si fazë e parë e procesit ku bëhet vlerësimi i dokumenteve të dhura për thirrjen. **Procesi i vlerësimit përmbajtësor**- vlerësimi i idesë së projektit;

Kriteret e vlerësimit janë të përcaktuara sipas udhëzuesi i vlerësimit për Programin për Zhvillim Rajonal të Balancuar kategoria Start-UP. Për të kaluar fazën e vlerësimit përmbajtësor, projekt propozimi duhet të arrijë së paku 50 pikë. Pas vlerësimit, aplikantët renditen sipas pikëve të fituara. Aplikimet me pikët më të larta përzgjedhen si përfitues deri në shpenzimin e buxhetit në dispozicion kurse pas shpenzimit të buxhetit, pjesa tjetër e aplikuesve që kanë arritur së paku 50 pikë mbeten në listën e pritjes/rezervë dhe renditja e listës rezervë do të jetë nga aplikantët me më së shumti pikë deri tek ata me më pak pikë të fituara.

Ankesat

Pas publikimit të rezultateve, aplikantët adresojnë ankesat e tyre në lidhje thirrjes përmes sistemit online këtë vit e përcaktuar në e-mail sipas rajonit zhvillimor të aplikuesit krahasuar me vitet e kaluara ku ankesat janë pranuar në mënyrë fizike.

Udhëzuesi për implementim të Programit

Ministria e Zhvillimit Rajonal gjithashtu aplikon Udhëzuesin për implementim të Programit PZHRB kategoria Start-Up në të cilin udhëzues jep udhëzime të qarta rreth procesit të implementimit të projekteve përfituese nga Thirrja për propozime të PZHRB që MZHR lanson çdo vit. Udhëzuesi përcakton rregullat e zbatimit të projektit afatet e implementimit, financimin dhe monitorimin të gjitha të përcaktuara sipas udhëzimit Administrativ (MZHR) nr: 01/2018 i plotësuar dhe ndryshuar me Udhëzimin Administrativ 02/2018 dhe 01/2022 për kushtet dhe kriteret e përkrahjes së bizneseve dhe ndërmarrësve të rinjë nga Programi për Zhvillim Rajonal të balancuar "PZHRB".

Gjetjet e Anketës - Programi PZHRB, 2018-2022

Kategoria Start Up

Objektivi 1. Bizneset aktive nga Skema e Granteve - Kategoria Start Up PZHRB 2018-2022

Themelimi i bizneseve të reja Start Up është një nga sfidat më të mëdha në mjedisin biznesor përkundër potencialeve dhe mundësive që këto biznese ofrojnë. Krahas kësaj edhe qëndrueshmëria e tyre kërkon kohë të gjatë të pjekurisë së tyre në treg. Këto sfida padyshim që i kanë përcjellur edhe bizneset përfituese të kategorisë Start Up nga programi PZHRB për periudhën 2018-2022.

Ky kapitull paraqet të gjeturat kryesore nga anketimi (98) respondentëve biznese përfituese aktive nga totali i (473) pyetësorëve të dërguar online tek përfituesit e këtij programi për periudhën 2018-2022. Pyetësi është shpërndarë për të gjithë përfituesit e Skemës së Granteve PZHRB 2018-2022 të kategorisë Start Up në pesë rajone zhvillimore në Republikën e Kosovës.


Periudha kohore	2018	2019	2020	2021	2022
Përqindja e respondentëve që kanë marrur pjesë në anketim nga përfituesit e Grant Skemës PZHRB (Start Up) 2018-2022	13%	18%	15%	18%	35%
Bizneset aktive në (%) nga pjesëmarrësit në pyetësor (biznese përfituese)	67%	67%	77%	100%	97%
Biznese jo-aktive të deklaruara sipas respondentëve në (%)	33%	33%	30%	0	3%

Tabela 2. Pasqyrimi i projekteve përfituese sipas respondentëve, kategoria Start Up- PZHRB, 2018-2022

Në tabelë është paraqitur në (%) numri i respondentëve që kanë marrë pjesë në anketim nga përfituesit e Grant Skemës PZHRB kategoria Start UP për periudhën 2018-2022. Nga kjo vërejmë që pjesëmarrje më të vogël kemi në vitin e parë të implementimit me 13% të mostrës së përfaqësimit, si dhe pjesëmarrje më të lartë të përfaqësimit me 35% të tyre për vitin 2022 si viti i pestë i implementimit të këtij programi.

Bazuar në numrin e pjesëmarrësve si respondentë në pyetësor nga Skema PZHRB vërejmë që mbi 50% e projekteve përfituese janë ende aktive në treg dhe sipas këtyre të gjeturave si institucion vlerësojmë që Skema e mbështetjes së sektorit privat ka arritur ndikimin e saj pozitiv që është synuar në krijimin bizneseve të reja të qëndrueshme në treg.

Në grafikun më poshtë kemi paraqitur në (%) bizneset të deklaruara si aktive nga respondentët e përgjigjur për periudhën 2018-2022 dhe numrin e bizneseve të deklaruara si jo-aktive për këtë periudhë. Sipas mostrës përfaqësuese që është gjeneruar nga ky anketim shohim një trend pozitiv të bizneseve aktive në raport me bizneset jo aktive, i cili trend mbizotëron në çdo vit që nga viti 2018 deri në vitin 2022. Grafiku i mëposhtëm paraqet një pasqyrim, gjendje reale nga përgjigjet e përfituesve pjesmarrës në pyetësor nga Skema e Grantëve të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar PZHRB të kategorisë Start Up.



Grafikoni 7. Paraqitja e biznesve aktive sipas respondentëve kategoria Start Up PZHRB 2018-2022

Objektivi 2. Të dhënat demografike të përfituesëve- Kategoria Start Up-PZHRB 2018-2022

Në pyetësin e shpërndarë për të gjithë përfituesit e Skemës së Granteve PZHRB 2018-2022 janë shtjelluar të dhënat demografike të përfituesve të Skemës së Granteve. Në analizë janë paraqitur *mosha mesatare; përkatësia etnike; gjinia; përgatitja shkollore*. Mëposhtë janë shtjelluar secila prej tyre në mënyrë të veçantë për të pasqyruar sa më detajisht këto të dhëna.

Periudha kohore	Vitet	2018	2019	2020	2021	2022
Mosha mesatare e përfituesit	Vitet	32	34.75	36.2	31.7	30.8
Përkatesia etnike	Shqiptar	3	11	8	10	54
	Serb	0	0	1	0	2
	Boshnjak	0	0	1	0	1
	Turk	1	1	0	0	3
	Rae	0	0	0	0	0
	Tjetër	0	0	0	0	2
Gjithsej		4	12	10	10	62
Gjinia	Grua	1	4	2	5	24
	Burrë	3	8	8	5	38
Gjithsej		4	12	10	10	62
Përgatitja shkollore	Student	0	0	0	0	3
	Fillor	1	0	0	0	1
	Mesëm ose ekuivalent	0	5	1	1	12
	Universitar (Master dhe Bachelor)	3	7	9	9	45
	Tjetër	0	0	0	0	1
Gjithsej		4	12	10	10	62


Tabela 3. Të dhënat demografike të respondentëve të përgjigjur nga projektet përfituese kategoria Start Up PZHRB, 2018-2022

Mosha mesatare - kategoria Start Up - PZHRB, 2018-2022



Në këtë pjesë të analizës kemi shtjelluar të dhënat demografike të skemës së përfituesëve të Programit PZHRB, kategoria Start Up për periudhën 2018-2022 të implementimit nga (respondentët të cilët janë përgjigjur në pyetësor), me qëllim të pasqyrit të këtyre të dhënave si karakteristikë e këtij programi. Ndër vite kategoria Start Up ka pasur kërkesa shumë të larta të financimit për ide projekte dhe njëherit është kategoria me Lotin më të kërkuar në kuadër të këtij Programi. Gjithashtu këtë Lot (Start Up) e karakterizon edhe mosha më re e aplikuesëve dhe e përfituesëve të projekteve për dallim nga Lotet tjera të kësaj Skeme.


Në grafikonin e mëposhtëm kemi paraqitur moshën mesatare të përfaqësuesëve të biznesit nga (respondentët e përgjigjur si përfitues të Skemës PZHRB) në kategorinë Start Up të periudhës implementuese 2018-2022. Nga kjo vërejmë që dy vitet e fundit kemi moshën më të re të përfaqësuar në këtë kategori që nga fillimi i implementimit të kësaj thirrje. Siç edhe shihet në diagram vërejmë që në vitet 2021 dhe 2022 kemi moshën mesatare të përfaqësuar prej (31,7 dhe 30.80 vjeç).



Grafikoni 8. Mosha mesatare e gjeneruar nga përgjigjet e respondentëve, Start Up - PZHRB, 2018-2022

Etniciteti- kategoria Start Up - PZHRB, 2018-2022

MZHR përmes implementimit të programeve të saj ka ofruar qasje të barabartë për të gjitha grupet etnike që janë rezidentë në Kosovë, të cilët kanë ide dhe gatishmëri të tyre për të zhvilluar biznese që përkojnë me objektivat e Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar. MZHR përmes kësaj ka synuar ndikimin në ekonominë e gjithmbarshme në vend përmes diversitetit si një vlerë shumë e dobishme e shoqërisë. Bazuar në përgjigjet e respondentëve nga përfituesit e Grant Skemës, kategoria Start Up të programit PZHRB, vërejmë që përfaqësimi multietnik ende nuk është në nivelin e duhur të përfaqësimit, mirëpo MZHR vazhdimisht inkurajon grupet etnike që të aplikojnë sa më shumë dhe të jenë pjesë e përbashkët drejt një zhvillimi socio-ekonomik të balancuar nëpërmjet sjelljes së projekteve kreative e cilësore. Vlen të theksohet se në bazë të paraqitjes grafike në vitin 2022 kemi një përfaqësim më të madh të diversitetit etnik si përfitues të Skemës së Granteve PZHRB 2018-2022, konsideruar që këtë vit ka qenë edhe mostra më e madhe e përfaqësimit të Start UP bizneseve, edhe pse shqiptarët kryesojnë si përfitues të projekteve kjo edhe për faktin që janë edhe shumicë e përfaqësuar si etni.




Grafikoni 9. Përkatësia etnike më e përfaqësuar nga përgjigjet e respondentëve kategoria Start Up, PZHRB periudha 2018-2022

MZHR në bashkpunim me agjencionet zhvillimore duhet të promovojnë edhe më shumë Programin për Zhvillim të Balancuar PZHRB, veçanërisht kategorinë Start Up tek komunitetet (pakicë) të cilat nuk janë të përfaqësueshme sa duhet përmes projekteve përfituese, në mënyrë që kjo të ndikoj në rritjen e kërkesës për aplikim dhe rrjedhimisht të rritet edhe përfaqësimi me projekte në të ardhmën.


Gjinia më e përfaqësuar nga kategoria Start Up - PZHRB, 2018-2022

MZHR përmes Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar PZHRB është munduar të ndikojë në vazhdimësi në fuqizimin e grave në biznes përmes nxitjes së ndërmarrësisë, duke i inkurajuar ato që të zhvillojnë idetë e tyre për biznes përmes mbështetjes së Skemës së Granteve. Në diagramet më poshtë kemi të pasqyruar numrin e projekteve përfituese në gjini bazuar në përgjigjet e respondentëve për pesë vitet e implementimit të Programit PZHRB, Loti 1(Start-Up). Nga kjo shohim që ndër vite gjinia me pjesëmarrje më të madhe janë projektet përfituese nga burrat.



Garfikoni 10. Gjinia më e përfaqësuar në (%) nga respondentët kategoria Start Up, periudha 2018-2022

Meqenëse mostra më e përfaqësuar në këtë analizë nga pjesëmarrësit në pyetësor është në vitin 2022, ky vit është paraqitur në grafikun e mëposhtëm. Nga 62 përfitues pjesëmarrës në anketim, (61%) e tyre janë të gjinisë burrë dhe (39%) të tyre janë përfituese gra.



Garfikoni 11. Gjinia më e përfaqësuar në (%) nga respondentët, kategoria Start Up - PZHRB, 2018-2022


Edukimi - kategoria Start Up - PZHRB, 2018-2022

Kërkesat për kategorinë Start Up bazuar në numrin e aplikimit të Grant Skemës PZHRB, 2018-2022 janë gjithmonë në rritje. Ajo që vlen të theksohet është që çdo vit me rritjen e kërkesës dhe numrin e përfituesëve kemi çdo herë nivel më të arsimuar përfituesish të fushave të ndryshme. Ky mund të jetë një faktor shumë i rëndësishëm për bizneset, i cili mund të ndikojë që projektet të mbështetura nga MZHR përveç që jetësohen të jenë edhe më të qëndrueshme në treg, si rezultat i menaxhimit nga kua përfe mirë arsimuara në të nryshme. Ky mu. Në tabelën e mëposhtme vërejmë që përqindja më e lartë e arsimimit nga respondentët të cilët janë përgjigjur nga grant skema PZHRB kategoria Start Up, ndër vite është niveli arsimor univeristar (master, bachelor) i fushave të ndryshme. Ndërkaq karakteristikë e vitit 2022 është se këtë vit 5% e projekteve përfituese korrespondojnë me kategorinë *student* që tregon se kemi një interesim të lartë dhe iniciativë të rinjëve për këtë program në faza edhe më të hershme siç është faza e studimeve i cili tregon që motivimi për ide të reja ndërmrrëse nuk mungon.


Vitet		2018	2019	2020	2021	2022
Përgatitja shkollore	Student	0	0	0	0	5%
	Fillor	25%	0	0	0	2%
	Mesëm ose ekuivalent	0	42%	10%	10%	19%
	Universitar (Master dhe Bachelor)	75%	58%	90%	90%	72%
	Tjetër	0	0	0	0	2%
Gjithsej		100%	100%	100%	100%	100%

Tabela 4. Niveli i edukimit të respondentëve kategoria Start UP - PZHRB, 2018-2022


Edukimi - kategoria Start Up-PZHRB, periudha 2018-2022




Garfikoni 12. Paraqitja e nivelit të edukimit




Garfikoni 13. Paraqitja e nivelit të edukimit



Garfikoni 14. Paraqitja e nivelit të edukimit



Garfikoni 15. Paraqitja e nivelit të edukimit




Garfikoni 16. Paraqitja e nivelit të edukimit

Objektivi 3. Sektori më i financuar nga Programi PZHRB, Kategoria Start Up

Ministria e Zhvillimit Rajonal përmes implementimit të këtij Programi është përkushtuar në vazhdimësi të nxisë rritjen e ndërmarrësve në sektorin e prodhimit përmes financimit të programeve të saj, mirëpo çdo herë ka rezultuar që sektori i shërbimeve të jetë sektori më i financuar për nga vlera dhe nga numri i projekteve nga kjo skemë. Një nga faktorët që ka ndikuar në këtë rezultat është padyshim, edhe të kërkesa më e madhe në këtë sektor.

Sektori	% 2018	% 2019	% 2020	% 2021	% 2022
Podhim/ Përpunim	25%	25%	20%	50%	27%
Shërbim	75%	75%	80%	50%	73%
Gjithsej	100%	100%	100%	100%	100%

Tabela 5. Paraqitja në % e sektorit më të financuar nga përgjigjet e respondentëve, kategoria Start Up - PZHRB, 2018-2022



Garfikoni 17. Paraqitja e sektorit më të financuar kategoria Start Up -PZHRB, 2018-2022, sipas përgjegjeve të respondentëve

Sektori (veprimtarisë) më të financuara nga kategoria Start Up - PZHRB, 2018-2022

Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
• Shërbime gjeodezike; • Shërbime pastrimi, deratizim, dezinfektim etj;	• Shërbime inxhinierike; • Marketing digjital dhe shërbime këshilluese për biznese;	• Shërbime inxhinierike arkitekturë;	• Rrobaqepësi; • Financa/Kontabilitet;

Tabela 6. Paraqitja e sektorit (veprimtarisë) më të financuar të projekteve përfituese Start Up PZHRB 2018-2021 sipas respondentëve

Prodhim/Përpunim: • Prodhim dhe përpunim nga druri; • Përpunim i perimeve dhe pëmeve; • Përpunim i mishit.	Viti 2022	Shërbim: • Design/rrobaqepësi; • Shërbime inxhinierike; • Shërbime të fotografisë, xhirime; • Gastronomi.
---	-----------	---


Tabela 7. Paraqitja e sektorit (veprimtarisë) më të financuar të projekteve përfituese Start Up PZHRB 2022 sipas respondentëve

Objektivi 4. Ndikimi i financimit tek projektet e programit PZHRB, 2018-2022-Kategoria Start Up

Në matjen e ndikimit të financimit në realizimin e ideve të projekteve të biznesit më poshtë kemi paraqitur përqindjen (%) e realizimit të projekteve në kategorinë Start Up për vitet 2018-2022 sipas përgjigjeve të respondentëve. Nga kjo vërejmë që ndikimi që ka pasur Skema e Granteve ka qenë *i lartë* në fillimin e realizimit të ide-projektit të tyre. Ndikimi i financimit si matës i realizimit të idesë së projektit nga përfituesit është vlerësuar në mënyrë pozitive nga shumica e respondentëve përkundër sfidave shtesë që kanë pasur gjatë themelimit dhe implementim të këtyre projekteve përmes Programit PZHRB nga kategoria Start UP.

Si ka ndikuar financimi i projektit tuaj në realizimin e objektivave të idesë së biznesit tuaj?					
%	(2018	2019	2020	2021	2022
Ndikim minimal	0%	17%	0%	10%	11%
Ndikim mesatar	0%	25%	30%	50%	31%
Ndikim të lartë	75%	33%	20%	40%	40%
Ndikim shumë të lartë	25%	25%	50%	0%	18%
Tjetër	0%	0%	0%	0%	0%
Gjithsej	100%	100%	100%	100%	100%

Tabela 8. Paraqitja e ndikimit të financimit tek projektet përfituese Start Up- PZHRB, 2018- 2022 sipas respondentëve




Grafikoni 18. Paraqitja e ndikimit të financimit tek projektet përfituese Start Up- PZHRB 2018- 2022 sipas respondentëve

Mbulueshmëria e kostos së projekteve - kategoria Start Up - PZHRB, 2018-2022

Më poshtë kemi pasqyruar në mënyrë tabelare dhe grafike përgjigjet në (%) nga respondentët e Grant Skemës PZHRB kategoria Start UP, për vitet 2018-2022 në lidhje me mbulueshmërinë e kostos së paisjeve të nevojshme për realizimin e projekteve. Nga kjo vërejmë që numri më i madh i tyre janë përgjigjur me (Po), që vlera financiare e përfituar nga skema e granteve ka qenë e mjaftueshme për të filluar jetësimin e idesë së biznesit të tyre. Ndërkaq përqindja tjetër e tyre janë përgjigjur me opsionin (Jo) dhe (Tjetër) duke dhënë edhe arsyet e tyre të cilat janë shtjelluar më poshtë.

A ka mbuluar mjaftueshëm koston e paisjeve të nevojshme për projektin tuaj vlera e përfituar financiare nga Skema e Granteve (Start UP)?					
(%)	2018	2019	2020	2021	2022
Po	75%	83%	50%	60%	69%
Jo	25%	8%	0%	20%	8%
Tjetër	0%	8%	50%	20%	23%
Gjithsej	100%	100%	100%	100%	100%

Tabela 9. Paraqitja e mbulueshmërisë së kostos së projekteve përfituese Start Up PZHRB 2018- 2022 sipas respondentëve




Grafikoni 19. Paraqitja e mbulueshmërisë së kostos së projekteve përfituese (%) Start Up PZHRB 2018- 2022 sipas respondentëve

Përgjigjet e respondentëve nga opioni (Tjetër) në lidhje me pyetjen: A ka mbuluar mjaftueshëm koston e paisjeve të nevojshme për projektin tuaj vlera e përfituar financiare nga Skema e Granteve (Start Up - PZHRB)?

2019	2020
• Deri në një masë;	• Për shkak që pasijet gjeodezike kanë një kosto shumë të lartë vlera e grantit ka qenë e pamjaftueshme për të mbuluar të gjitha paisjet e nevojshme; • Nevoja për paisje të reja; • Nevojiteshin paisje dhe materiale të tjera por që në vitin 2020 nuk ishin të lejuara të financoheshin nga MZHR; • Duhet paisje shtesë; • Cmimet;
2021	2022
• Duhet edhe paisje tjera për zhvillim më të lartë; • Duhet edhe investime tjera;	• Vlera e financimit është e ulët; • Vlera jo shumë e madhe e grantit; • Vlera e bashkëfinancimit shumë e lartë, • Mesatarisht po, nevojë për investime më të mëdha; • Ka mbuluar vetëm për fillim; • Nevojë për mjete të tjera për zgjerim; • Nuk ka qenë e mundur të sigurohen të gjitha paisjet e projektit me këtë grant; • Janë kërkuar edhe shumë paisje të tjera për fillimim e punës; • Investim 100% me shumë për të aktivizuar biznesin; • Deri në një masë; • Shuma e vogël për Start up - duke pasur parasysh rritjen e çmimeve në treg.


Qëndrueshmëria e projekteve përfituese kategoria Start Up - PZHRB 2018-2022

Në grafikun e mëposhtëm kemi paraqitur në (%) përgjigjet e respondentëve nga Skema e Grantëve PZHRB kategoria Start Up në lidhje me qëndrueshmërinë e bizneseve të tyre. Në pyetjen se sa e konsideroni biznesin tuaj të qëndrueshëm në treg, sipas përgjigjeve në pyetësor bizneset përfituese janë shprehur në përqindje të lartë në lidhje me qëndrueshmërinë e biznesit të tyre. Përkundër sfidave të brendshme dhe të jashtme ata shohin jetëgjatë dhe të qëndrueshëm bizneset e tyre.



Garfikoni 20. Paraqitja grafike e përgjigjeve të respondentëve mbi qëndrueshmërinë e bizneseve, kategoria Start Up 2018-2022

Në paraqitjen grafike më poshtë kemi paraqitur përgjigjet e respondentëve në lidhje me qëndrueshmërinë e punësimit. Ne kemi analizuar numrin e përgjithshëm i të punësuarve në fillim të implementimit të projekteve duke krahasuar me numrin e të punësuarve aktual të bizneseve përfituese (të regjistruar në Atk). Referuar grafikut të mëposhtëm rezulton një trend mjaft pozitiv në rritje, ku shihet qartë se numri i të punësuarve aktual ka pësuar rritje në disa nga vitet e implementimit në krahasim me numrin e të punësuarve fillestar që janë paraqitur nga bizneset e kategorisë Start Up.



Garfikoni 21. Paraqitja grafike e qëndrueshmërisë së punësimit kategoria Start Up 2018-2022 sipas përgjigjeve të respondentëve


Pasqyrimi i nivelit të eksportit nga bizneset përfituese kategoria Start Up-PZHRB, 2018-2022

Në këtë analizë kemi analizuar bizneset përfituese të Skemës së Granteve PZHRB në bazë të përgjigjeve të pyetësorëve nga kategoria Start Up që nga viti 2018-2022 të cilat kanë arritur që përveç qëndrueshmërisë së tyre në treg, edhe të eksportojnë produktet\shërbimet e tyre. Në bazë të paraqitjes tabelare vërejmë:

A keni arritur te eksportoni produkte/shërbime?					
(%)	2018	2019	2020	2021	2022
Po	0%	8%	40%	50%	10%
Jo	100%	92%	50%	50%	85%
Tjetër (jo-relevante)	0%	0%	10%	0%	5%
Total	100%	100%	100%	100%	100%

Tabela 10. Paraqitja e eksportit nga bizneset përfituese Start Up PZHRB 2018- 2022 sipas respondentëve

Në grafikonin e mëposhtëm kemi pasqyruar nivelin e eksportit nga bizneset përfituese nga skema e granteve kategoria Start Up, bazuar në përgjigjet e respondentëve që kanë marr pjesë në pyetësor.



Garfikoni 22. Paraqitja grafike e eksportit nga PZHRB 2018-2022, kategoria Start Up sipas respondentëve

Llojet e shërbimeve dhe vendet e eksportit - kategoria Start Up - PZHRB, 2018-2022

Nxitja e eksportit është një sfidë shumë e madhe për tregun vendor duke ditur që importi i produkteve është shumë i lartë në krahasim me ato të eksportuara. Shkak është edhe mungesa e produkteve vendore dhe niveli i ulët i prodhimit në vend, duke pasqyruar kështu një deficit të lartë tregtar të eksportit. Edhe pse Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar ka si qëllim nxitjen e eksportit dhe zvogëlimin e importit përmes mbështetjes së bizneseve në sektorin privat, nga të dhënat bazuar në këtë analizë mbetet ende punë për tu bërë. Disa prej produkteveve/shërbimeve që kanë arritur të eksportojnë disa prej bizneseve përfituese të Grant Skemës PZHRB 2018-2022, kategoria Start Up sipas përgjigjeve të respondentëve janë paraqitur mëposhtë:

Për ato biznese që janë përgjigjur në pyetjen rreth eksportit	(specifiko shërbimin/produktin)	(specifiko, vendin eksportit)
Viti 2019	Veshje	USA, Gjermani, Itali, Francë, Arabi, Angli, Irland
Viti 2020	Projekte arkitektonike	Zvicer
	Shërbime reklamuese	Slloveni, Zvicer, Gjermani
	Projekt interiori	Gjermani
Viti 2021	Veshje të punës	Zvicer
Viti 2022	Shërbime të menaxhimit të rrjeteve POS	Shba
	Montazha online për kompani të ndryshme	(nuk është specifiku vendi i eksportit)

Tabela 11. Paraqitja e vendit të eksportit të projekteve përfituese Start Up PZHRB 2018- 2022 sipas respondentëve

- Disa prej bizneseve përfituese edhe pse janë përgjigjur që janë eksportuese të shërbimit/prodhimit të tyre ato nuk kanë specifikuar vendin e eksportit.

Objektivi 5. Sfidat gjatë themelimit të bizneseve - kategoria Start Up - PZHRB 2018-2022

2018

- **dokumentacioni, licenca;**
- gjetja e klientëve.

2020

- **kriza globale covid-19;**
- **procedura e hapjes së biznesit, dhe menaxhimi i pajisjeve pas blerjes;**
- **pandemia covid-19;**
- gjetja e klienteve në fillim;
- **vlera e vogël e fituar financiare e grantit;**
- **pandemia Covid 19, mbyllja e aktiviteteve gastronomike;**
- **pandemia Covid 19, shitja e produkteve;**
- njohja me punën, klientët, furnitorët, tregjet, çmimet e kështu me radhë.

2019

- reklamimi;
- përgaditja jo-adekuate profesionale në fushën e përkatëse;
- **pandemia covid 19;**
- **vështirësi financiare,**
- produkt i ri në treg;
- mungesa e njohurive për shërbimet përkatëse;


2021

- **numri i vogël i paisjeve;**
- konkurrenca;
- **çmimet e larta për materialet bazë;**
- hyrja në treg;
- **bashkëfinancimi;**
- **pandemia Covid-19, ngritja e çmimeve;**
- sfida me lokacionin e biznesit;
- kërkesa e tregut, **shuma e vogël financimit** ka pamundësuar që të investimin në kërkesa tjera siç është marketingu.

- **vlera e ulët e grantit, tregu jostabil;**
- **sigurimi i makinerive;**
- sfida financiare, mungese e fondeve për inventar, marketing, për qira etj;
- **si proces administrativ, themelimi i biznesit është shumë e thjeshtë; si proces implementues sfida gjatë themelimit të biznesit:**
- **sfida e parë** mjetet financiare, parapagimi i shumës së financimit me 50% të vlerës;
- **sfida e dytë** gjetja e lokacionit;
- **sigurimi i paisjeve, i lokalit dhe sigurimi i stafit profesional;**
- shpenzimet tjera të paparashikuara;
- **bashkëfinancimi;**
- kriza ekonomike, ndryshimi i çmimeve, mungesa e produkteve e shumë akterë të tjerë;
- procedura për licencim, vështërsitë e inflacionit;
- gjetja e klientëve;
- hulmutimi i tregut, inventari për zyrë, përzgjedhja e stafit;
- sfidë fillestare qeraja e parakohshme deri në pranimin e mjeteve, pagesat e punëtorëve mbulimi i shpenzimeve të tjera administrative dhe të marketingut;
- **mungese e paisjeve të tjera;**
- bartja e paisjeve nga dëmtimet e mundshme;
- sfida ekonomike, më se shumti kriza e punëtorëve;
- futja në treg, problemet e shitjes;
- konkurrenca në treg;
- gjetja e klientëve; pagesat e punëtorëve pavarësisht punës;
- **sigurimi i mjeteve sepse nga Granti për sigurimin e elementeve me kosto me te lartë nuk ka mjaftuar;**
- reklamimi i biznesit dhe aftësimi profesional;
- lidhja me partneret nga jashtë vendit për t'i promovuar shërbimet tona të outsourcing;
- sigurimi i lëndës së parë për prodhim;
- mbështetja financiare;
- **pandemia dhe lufta në Ukrainë, inflacioni;**
- ikja e punëtorëve dhe pagesat jo direkte nga pronarat por vonesat.
- hapja e biznesit, investime shtesë mungesë buxheti;
- përballimi i shpenzimeve fikse (qiraja, rryma, uji etj);
- financat dhe gjetja e një hapsire punuese;
- sfida e zhvillimit (punësimi, zgjerimi i punëve etj);
- gjetja e lokalit, e punëtorit;
- lëvizja e çmimeve në treg;
- burokraci;
- tregu njohja me klientë;
- **gjetja e paisjeve prodhuese me çmim të lirë.**

Fazat e aplikimit të programit kategoria Start Up - PZHRB 2018-2022

Në pyetjen e parashtruar në cilën prej fazave të aplikimit keni hasur në vështirësi, kemi paraqitur në (%) përgjigjet nga bizneset përfituese 2018-2022 në lidhje me pakon e aplikimit të grant skemës PZHRB kategoria Start Up. Mëposhtë janë paraqitur edhe rekomandimet e respondentëve në lidhje me këtë pako.



Garfikoni 23. Paraqitja fazeve të aplikimit kategoria Start Up PZHRB 2018-2022 nga përgjigjet e respondentëve


Pakoja e dokumenteve të aplikimit	Afati për aplikim	Dokumentacioni shtesë	Operimi me sisemin e aplikimit
- procedura më të thjeshtësuara të aplikimit; - burokraci; - shumë dokumentacion për një startup; - i vështirë aplikimi i metodave me dokumentacion; - informacionet e shumta të kërkuara; - thjeshtësim të procedurave.	- afati për aplikim të jetë i hapur së paku 1 muaj pasi që procesi i përgatitjes së dokumenteve zgjatë kohë më të gjatë; - afati do të duhej të jete pak me i gjate, te pakten 45 dite; - afati i aplikimit 30 dite nga dita e shpalljes; - afati i aplikimit duhet të jetë 3 javë për shkak të kohës së përgatitjes e dokumentave, përpilimi i projektit, sistemi dhe gjëra të pa planifikuara; - afatet e shkurta kohore për dokumentet e kërkuara.	rregullimi i dokumenteve shtesë pas perfitimit te grantit një veprim shtesë i mundimshem per shkak të udhëtimit për të sjellur dokumentët fizikisht;	- fazë e komplikuar për mua E - kosova; - sistemi me shumë probleme me shumë ngarkesa; - problem me platformën E-kosova.

Tabela 12. Paraqitja e rekomandimeve për pakon e aplikimit nga projektet përfituese 2018- 2022 sipas respondentëve

Objektivi 6. Sfidat gjatë implementimit-Programi PZHRB 2018-2022

Kategoria Start Up

Në pyetjen: *përshkruani sfidat me të cilat jeni përballur gjatë implementimit të projektit*, në mënyrë grafike (%) janë paraqitur përgjigjet e përfituesve të skemës së granteve PZHRB (Start Up) 2018-2022. Ndër sfidat kryesore që shumica e tyre janë përgjigjur është bashkëfinancimi. Ata gjithashtu kanë kërkuar si mundësi që financimi apo (dhënia e mjeteve) të nga MZHR të bëhet me një afat (pagesë), si dhe sipas tyre do të ishte mirë të kishte një kanal komunikimi më të drejtpërdrejtë me përfituesit e bizneseve, pasi që një monitorues për shumë përfitues është konsideruar që është pak për të i'u përgjigjur nevojave dhe kërkesave të përfituesëve në realizim të projektit.



Garfikoni 24. Paraqitja e sidave gjatë implementimit kategoria Start Up PZHRB 2018-2022 sipas përgjigjeve të respondentëve

Objektivi 7. Ndikimet e drejtpërdrejta pozitive si rezultat implementimit të projektit - Programi PZHRB 2018-2022, Kategoria Start Up



HAPJA E BIZNESEVE START UP

- Zhvillim i ideve kreative;
- Hapja e bizneseve të reja në treg;
- Produkte/shërbime të reja në treg;
- Rritja e të ardhurave për përfituesit;
- Zhvillimi i bizneseve premtuese;
- Zhvillim të veprimtarive të ndryshme dhe realizim të ëndrrave për shumë të rinjë;



NDIKIMI DREJTËPËRDREJTË I PAISJEVE

- Cilësi në prodhim/shërbim;
- Makineri me programe moderne, të shpejta;
- Efikasitet në punë;
- Produktivitet dhe profesionalizëm në punë;
- Zhvillim i biznesit, mundësi, kreativitet dhe përgjegjësi;




PUNËSIMI

- Vetpunësimi që është drejtpërdrejt pozitiv;
- Vetpunësim, motivim për punë;
- Hapje e vendeve të reja të punës në sektorin e prodhimit/shërbimit;
- Angazhim, vetpunësim, të ardhura materiale;
- Vetpunësim dhe hapje e vendeve tjera të punës;
- Vetëpunësim/jo-emigracion;



NDIKIMI NË TREG

- Njohja me klientë të rinjë;
- Zgjerimi i tregut përmes sjelljes së produkteve/shërbimeve të reja;
- Rritja e konkurrueshmërisë në treg;
- Eksporti shërbimeve jashtë vendit duke i kontribuar ekonomisë së vendit;



GRUAJA NDËRMARRËSE

- Ndikim në zhvillimin e karrierës tek femrat ndërmarrëse, ndikimi pozitiv për shkak të nevojës për mbështetje që të zhvillojnë aftësitë e tyre ndërmarrëse;
- Ndikim në emancipimin e shoqërisë përmes mbështetjes së gruas ndërmarrëse;



NDIKIME TË TJERA

- Progres për rininë;
- Ndikimi në ndalimin emigrimit të të rinjeve në vendet tjera;
- Ndryshime të drejtpërdrejta, pozitive emocionale ose shpirtërore përmes mbështetjes së të rinjeve në ndërmarrësi;
- Pozitive në çdo gjë;


Tabela 13. Paraqitja e ndikimit të programit PZHRB- Start UP në projektet përfituese 2018- 2022 sipas përgjigjeve të respondentëve

Matja e pritshmërive nga përfituesit e bizneseve - Kategoria Start Up PZHRB, 2018-2022

Në pyetjen e parashtruar *A planifikoni që pas kalimit të periudhës monitoruese pas dy viteve të aplikoni me ndonjë projekt tjetër për financim në Programet e MZHR-së, (73%) të përfituesëve janë përgjigjur me (Po) do të aplikonin në një rast të dytë në Skemën e Granteve të Mzhr-së.*

A planifikoni që pas kalimit të periudhës monitoruese prej dy viteve të aplikoni me ndonjë projekt tjetër për financim në Programet e MZHR-së?					
2018-2022	Po	Jo	Nuk e di	Tjetër jo-relevante	Pa përgjigje
	73%	6%	16%	2%	2%

Tabela 14. Paraqitja e përgjigjeve në (%) lidhje me pritshmëritë e projekteve përfituese 2018- 2022, sipas respondentëve



Garfikoni 25. Paraqitja grafike e përgjigjeve në lidhje me aplikimin Start Up-PZHRB 2018-2022 sipas respondentëve

Objektivi 8. Bizneset jo-aktive kategoria Start-Up PZHRB 2018-2022 - Faktorët e mbylljes

Në këtë pjesë janë analizuar 33 % e bizneseve të deklaruara si jo-aktive të kategorisë Start Up, të programit PZHRB për periudhën 2018-2022 të implementimit, nga përgjigjet e pyetësorit në lidhje me *arsyet e mbylljes së bizneseve të tyre*, të cilat i kemi listuar si më poshtë. Në formë tabelare janë paraqitur si faktorë të jashtëm dhe të brendshëm të mjedisit biznesor.

Specifiko arsyet e mbylljes së biznesit 2018-2022	Faktorët që lidhen direkt me Programin PZHRB - Start UP	Faktorët tjerë të jashtëm
	Vlera e financimit/ bashkfinancimit;	- Ndikimi I Pandemisë Covid 19; - Tregu/konkurrenca; - Tjetër: migrimi I popullsisë; - Tjetër: arye personale; - Resurset humane;
	Sektori më i prekur	Rekomandimet (biznese joaktive)
	Shërbimi	<i>bizneset e reja përfituese të mbështeten me komplet buxhetin e kërkuar.</i> <i>mbështetja vetëm me një buxhet të pjesshëm nga ana e Ministrisë nuk po i ndihmon sa duhet biznesit të ri;</i> <i>mbështetja e gjinisë femërore në zhvillim të bizneseve;</i> <i>...mbështetje për start up sa më shumë;</i>

Tabela 15. Faktorët e mbylljes së bizneseve përfituese (Start Up, PZHRB 2018- 2022)


Objektivi 9. Rekomandimet nga bizneset përfituese -PZHRB 2018-2022

Kategoria Start Up

Nga (98) bizneset përfituese të programit Start-Up PZHRB 2018-2022 të cilët janë përgjigjur në pyetësonin në lidhje me rekomandimet e tyre, vetëm 43 prej tyre apo 44% e totalit kanë dhënë rekomandimet rreth skemës së granteve të cilat i kemi listuar si më poshtë.

Rekomandimet nga përfituesit e Programit PZHRB Start UP 2018-2022	%
Të rritet vlera e financimit nga MZHR	28%
Të mbështeten sa më shumë dhe në vazhdimësi bizneset (Start up)	26%
Bizneset që janë treguar të suksesshme të mbështeten me mjete shtesë	7%
Të organizohen sesione informuese para thirrjes	2%
Përkrahje direkte në subvencionim të prodhimit	2%
Mbështetje në ide inovative dhe mbështetje ndaj grave	5%
Lehtesira në fillim dhe në vazhdimësi për Start Up	5%
Të kënaqur dhe falenderues	14%
E gjithë procedura e granteve të bëhet online	2%
Te lejohen ndryshimet në përqindje më të madhe se 10%	2%
Mbështetje shtesë me mjete financiare	5%
Të zvogëlohet koha e pritjes për mbështetje shtesë (periudhë e gjatë 2 vjeçare)	2%
Gjithsej	100%

Tabela 16. Rekomandimet nga përgjigjet e respondentëve biznese përfituese (Start Up, 2018- 2022)



Grafikoni 26. Rekomandimet nga përgjigjet e respondentëve nga kategoria (Start Up, PZHRB 2018- 2022)



Bazuar në të gjeturat e pyetësorit nga përgjigjet e respondentëve në kuadër të Programit PZHRB kategoria Start Up, periudha e implementimit për vitet 2018-2022, në lidhje me realizimin e objektivave të përcaktuara përfundojmë që mbështetja e kësaj kategorie është kërkesë shumë e lartë dhe e domosdoshme në treg, e cila implementohet nga MZHR. Duke marrur parasysh të gjitha të gjeturat dhe rekomandimet që janë gjeneruar nga përfituesit e kësaj skeme, ndikimit të programit në aspektet tjera si financiare, administrative si dhe sfidat e themelimit dhe e implementimit të projekteve konsiderojmë që kjo Skemë ka ndikime shumë pozitive në ngritjen e ndërmarrësisë përmes: *nxitjes së ndërmarrësve të rinj, gjenerimin e vendeve të reja të punës, zhvillimit të qëndrueshëm socio-ekonomik* e cili potencialisht qon në një standard më të lartë jetese për qytetarët. Start Up bizneset përveç rritjes së konkurrencës në treg ato kanë një ndikim shumë të madh edhe në nxitjen e inovacionit përmes sjelljes së produkteve dhe shërbimeve në treg. Këto biznese gjejnë tregun më të përshtatshëm në vendet të cilat janë në ekonominë në zhvillim siç është edhe Kosova. Andaj konsiderojmë që edhe Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar kategoria Start Up përmes implementimit është duke dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillim socio-ekonomik rajonal, dhe të qëndrueshëm përmes zvoglimit të pabarazive rajonale.

Rekomandime:

- **Rekomandohet që MZHR të avancojë qasjen ndaj kategorisë Start Up - PZHRB duke mundësuar një thirrje të pakufizuar në afate të aplikimit dhe një mbështetje të MZHR-së nga ideja fillestare, inkubimi deri te financimi dhe realizimi i idesë/projektit. Të ipet mbështetje në mentorim, trajnime të fushave specifike deri në maturimin e biznesit, duke i mundësuar qëndrushmëri në treg; MZHR duhet të ngrisë kapacitetet e saj humane duke krijuar struktura profesionale për të mbështet këtë Lot.**
- **Referuar Udhëzuesëve për Aplikantë të PZHRB-së, MZHR duhet të mbështesë edhe kategorinë e Start Up-ve regjistrimi i të cilëve ka qenë para periudhës së financimit dhe të vendos kriteret e financimit të kësaj kategorie të Start Up që të kenë mundësi të gjitha bizneseve fillestare të cilat janë regjistruar edhe në një periudhë më të hershme para datës së thirrjes.**



- Të rritet vlera e financimit për kategorinë Start Up sipas sektorit (veprimtarisë) së projektit pasi që veprimtari të ndryshme kanë kosto të ndryshme paisjesh për realizimin e projektit; Vlera financiare mbështetur nga skema e granteve për këtë kategori prej (2000 deri 5000) është konsideruar e pamjaftueshme në mbulimin e kostos totale të një projekti. Analizuar projektet Start Up krahas shpenzimeve për paisje janë edhe edhe një sërë shpenzimesh që e obligon një biznes në detyrime si: lokacioni, shpenzimet e operimit etj. deri në fillimin e prodhimit. Andaj rekomandojmë që kostoja e paisjeve për secilin biznes Start UP të financohet në tërësi të projektit në bazë të (sektorit dhe veprimtarisë) në mënyrë që të mos kenë barriera në këtë aspekt.
- Referuar kërkesave të përfituesëve (respondentë nga pyetësi) rekomandohet që sesionet informuese që realizon MZHR rreth Skemes së Granteve të realizohen para hapjes së Thirrjes për aplikim, pasi që këto sesione do të ndihmonin në ekonomizimin e kohës së përgatitjes së ide projekteve dhe kryerjes së procedurave administrative nga aplikuesit.
- Bazuar në trajtimin e Udhëzuesit për Implementim për të stimuluar sa më shumë realizimin e implementimit të bizneseve sipas afateve kohore dhe periudhës së paraparë implementuese sipas Udhëzuesit, rekomandojmë që funksionalizimi i paisjes së financuar të specifikohet në marrëveshjen e nënshkruar mes palëve në kontratë.
- Të ofrohen më shumë informacione (vizuale) rreth procedurave të aplikimit dhe përgatitjes së dokumentacionit.
- Të mbështetet edhe më tutje gruaja ndërmarrëse duke promovuar sa më shumë këtë program tek kjo kategori në mënyrë që të ndikohet në përfaqësimin e gruas përmes bizneseve përfituese.
- Të analizohen çdo vit bizneset përfituese të kategorisë Start Up, në vitin e parë dhe të dytë të implementimit, gjë që do të mundësonte për të përcjellur më afër dhe në konsistencë sfidat, dobësitë, rreziqet dhe mundësitë gjatë ciklit jetësor të zhvillimit të tyre. Nga rezultatet e nxjerra nga kjo analizë do të mundësohej planifikim më i mirë dhe lehtësi më e madhe gjatë implementimit për përfituesin si dhe institucionin kontraktues që është MZHR.

Burimet e informacionit:

- **Analiza e Programit Zhvillimit Rajonal të Balancuar PZHRB 2018-2020;**
- **Analizat e Programit Zhvillimit Rajonal të Balancuar PZHRB 2022;**
- **Udhëzuesi për aplikantë, Skema e Granteve "Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar (PZHRB) 2023";**
- **Udhëzuesi për implementim, Skema e Granteve "Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar (PZHRB);**



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

PYETËSOR

Për bizneset përfituese nga Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar (PZHRB)

Skema e Granteve (Start Up) 2018 – 2022

Ky hulumtim bëhet me qëllim të matjes së ndikimit të implementimit të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar për vitet (2018-2022) tek bizneset e reja në kategorinë (Start Up). Ky pyetësor analizon vetëm përfituesit nga Skema e Granteve (PZHRB) e implementuar nga MZHR.

Kapitulli I

Informatat e përgjithshme

Emri i përfaqësuesit të biznesit: _____

Përkatësia etnike: _____

Mosha: _____

Gjinia: _____

Shkollimi: _____

Emri i biznesit: _____

Komuna: _____

Rajoni Zhvillimit Ekonomik: _____

Pozicioni i të intervistuarit në biznes:

Pronar/bashkëpronar

Drejtor/Drejtor Ekzekutiv

Menagjer i përgjithshëm

Tjetër (ju lutem specifikoni pozicionin tuaj) _____

Kapitulli II

Informatat e biznesit dhe ndikimi i financimit (PZHRB)

1. Biznesi juaj është përfitues i vitit:

- 2018
- 2019
- 2020
- 2021
- 2022

2. Sektori në të cilën vepron biznesi juaj:

- Prodhim
- Tregti
- Përpunim
- Shërbim
- Tjetër, Ju lutem specifikoni _____

3. Veprimtaria e biznesit përfitues (specifiko) : _____

4. A është aktiv biznesi juaj ende në treg?

- **PO** (Nëse po, vazhdo)
- **JO** (Nëse jo kalo në pyetjen 21)

5. Vlera financiare e përfituar dhe bashkëfinancuar në Skemen e Granteve (PZHRB)?

Vlera financimit _____ €;

Vlera e bashkëfinancimit _____ €;

6. Si ka ndikuar financimi i projektit tuaj në realizimin e objektivave idesë së biznesit ?

- Ndikim minimal
- Ndikim mesatar
- Ndikim të lartë
- Ndikim shumë të lartë
- Tjetër, Ju lutem specifikoni.....

7. A ka mbuluar mjaftueshëm koston e paisjeve të nevojshme për projektin tuaj vlera e përfituar financiare nga Skema e Granteve PZHRB?

PO

JO

Nëse jo (Arsyeto)

8. Numëro llojet e produkteve/shërbimeve me të cilët operon biznesi juaj:

- a. _____
- b. _____
- c. Tjetër _____

9. A ndikon produkti/shërbimi juaj në zvogëlimin e importit në treg?

Nëse po arsyeto?

10. A keni arritur të eksportoni produkte/shërbime ?

PO

JO

Nëse po specifikoj produktin/shërbimin _____

Specifikoj vendin për produktin/shërbimin e eksportuar (përfshirë sistemin online të operimit)

11. A e konsideroni biznesin tuaj biznes të qëndrueshëm në treg?

PO

JO

Nëse PO (Arsyeto)

Nëse JO (Arsyeto)

12. Ju lutem specifikoni nëse Thirrja për mbështetjen e bizneseve (PZHRB), kategoria Start Up mund të mbështesë edhe ndonjë veprimtari tjetër specifike si kërkesë e tregut?

Kapitulli III

(Punësimi)

13. Sa është numri i përgjithshëm i të punësuarve në biznesin tuaj me implementimin e projektit? (të regjistruar në ATK)

- Specifiko numrin ____ ;

Për bizneset në vitin e parë dhe të dytë të monitorimit:

14. A ka ndryshuar numri i të punësuarve në biznesin tuaj nga numri i paraqitur në fillim?

PO

JO

Nëse po, sa është numri aktual i të punësuarve?

- Specifiko numrin ____ ;
- **Kam zvogëluar numrin e punëtorëve;**
Arsyeto _____
- **Kam rritur numrin e punëtoreve;**
Arsyeto _____

15. Numri i të punësuarve sipas gjinisë ?

- Specifiko numrin ____ (meshkuj);
- Specifiko numrin ____ (femra);

16. Përkatësia etnike e të punësuarve aktual ?

- Specifiko numrin ____ Shqiptar;
- Specifiko numrin ____ Serb;
- Specifiko numrin ____ Boshnjak;
- Specifiko numrin ____ Goran;
- Specifiko numrin ____ Turk;
- Specifiko numrin ____ RAE;
- Tjetër, _____;

Kapitulli IV

Sfidat, mundësitë dhe rreziqet gjatë procesit të implementimit të Skemës së Granteve (PZHRB)

17. Përshkruani sfidat me të cilat jeni përballur gjatë themelimit:

Specifiko:

18. Në cilat prej fazave keni hasur vështirësi gjatë aplikimit dhe mendoni që duhet të ndryshojnë?

Pakoja e dokumenteve të aplikimit;

- **Vërejtjet dhe sugjerimet**

-
- Afati për aplikim;

- **Vërejtjet dhe sugjerimet**

-
- Dokumentacioni shtesë që është dashur të plotësohet pas shpalljes si përfitues i para kualifikuar;

- **Vërejtjet dhe sugjerimet**

-
- Operimi me sistemin E-Kosova:

- **Vërejtjet dhe sugjerimet**

-
- Tjetër, Ju lutem specifikoni _____

19. Përshkruani sfidat me të cilat jeni përballur gjatë implementimit të projektit? (përgjegje të shumëfishta)

- Komunikimi dhe paraqitja e përfaqësuesve të MZHR-së;
- Procesi i realizimit të vizitave në terren;
- Periudha e monitorimit;
- Bashkëfinancimi
- Pandemia Covid 19
- ?

Vërejtjet dhe sugjerimet e Juaja

20. Përshkruani ndikimet dhe ndryshimet e drejtpërdrejta pozitive si rezultat i implementimit të projektit?

Specifiko

21. A planifikoni që pas kalimit të periudhës monitoruese prej 2 viteve nga MZHR, të aplikoni përsëri me ndonjë projekt tjetër për financim në MZHR?

- Po;
- Jo;
- Nuk e di;
- Tjetër, _____

22. Specifiko arsyet e mbylljes së biznesit tuaj?

(përgjegje të shumëfishta)

- Ndikimi i Pandemisë Covid 19
- Vlera e financimit/bashkëfinancimit
- Tregu / konkurrenca
- Resurset humane
- Sigurimi i paisjeve

Elaboro përgjegjen/et

23. Rekomandimet tuaja

Faleminderit shumë për bashkëpunimin tuaj lidhur me plotësimin e këtij pyetësi!

